



Gjeje rrenën!

Mirëseerdhët në buletin e Faktoje! Ne zbulojmë gënjeshtat përmes fakteve! Ky botim do t'ju japë disa këshilla praktike si të mos mashtroheni nga lajmet e rreme.

Titulli i artikullit nuk përputhet me tekstin

Portalet kërkojnë klikime duke përdorur tituj të ekzagjeruar ose të shpikur, që i bëjnë njerëzit kuriozë, sepse klikimet u sjellin të ardhura.



Ngjallja e ndjenjave të forta
Nëse një lajm ju ngjall zemërim të madh, keqardhje, apo fyerje, bëhuni dyshues. Keqinformimi nganjëherë përpiqet të krijojë ndjenjat më të forta të mundshme tek njerëzit dhe kështu të bini pre e mashtrimeve.



Si të dallojmë lajmet e rreme?

Mbani mend: çdokush mund të thotë çfarëdo në internet!

Kini kujdes nga lajmet që nuk kanë autor dhe nuk citojnë burimin e informacionit.

“Mjafton që të nuhatet”, bima e cila bën mrekulli kundrejt këtyre 4 llojeve të tumoreve

Shërojeni Dhimbjeen E Gjunjëve Me Të Verdhtë Të Vezës: Recetë Super E Lehtë!

Shmangu operacionin e gjunjëve dhe kuroi në shtëpi dhimbjen e gjunjëve me këtë recetë të thjeshtë dhe Natyrale!

Dikush mund t’u thotë të vërtetën dhe prapë t’u keqinformojë. Kjo ndodh kur faktet nxirren nga konteksti apo ofrohen jo të plota.

BANK

Ndryshimet/ Whatsapp behet me lekë: Zbulohen kategoritë që do detyrohen të paguajnë

Admin 19 Hours Ago 0 3 Mins

Në fakt, bisedat mes personave do të vijojnë të jenë falas. Do të mund të paguajnë ata që duan të bëjnë reklamë për të rritur shikueshmërinë tek njerëzit.




Qëndroni të sigurt në internet duke qenë të kujdesshëm me mesazhet e panjohura!

Mund t'u vijë mesazhe të rreme ose telefonata që kërkojnë para, fjalëkalime ose të dhëna personale. Një rregull i mirë është mos u nxitoni që t'i klikoni.



Shenja që duhet t'u bëjnë të dyshoni

- Një mesazh që thotë se duhet të veproni menjëherë
- Dikush kërkon fjalëkalimin ose të dhënat tuaja bankare.
- Një mesazh thotë se keni fituar një çmim
- Një numër i panjohur ose i huaj
- Një mesazh me shumë gabime drejtshkimore.
- Një telefonues kërkon pagesë



Nëse diçka duket urgjente, e bujshme ose shumë e mirë për të qenë e vërtetë, kujdes!
Mos u nxitoni, mendoje qetë.



Gjeje rrenën!

Qëndroni të sigurt në internet duke qenë të kujdesshëm me mesazhet e panjohura!



Çfarë duhet të bëni

- Mos klikoni në faqe të panjohura
- Mos jepni kurrë fjalëkalimet tuaja
- Mos jepni të dhënat tuaja bankare
- Pyesni dikë që i besoni nëse nuk jeni të sigurt
- Përdorni fjalëkalime të forta.



Bëhuni dyshues!





A mund t'i besosh syve?



Cila nga këto foto mendoni se është e vërtetë?

(Mund të zgjidhni më shumë se një foto.)

a.



b.



c.



d.



Fotot b. dhe c. janë imazhe të modifikuara mbi të cilat është vendosur koka e Ramës. Fakteje gjeti fotot origjinale me anë të motorit të kërkimit pamor Google Lens, që gjen imazhe të ngjashme me atë që po kërkojmë.



Miti i muajit: Rritje apo indeksim?

Pensionet janë gjithmonë një temë e prekshme, e kështu, shpesh herë media të ndryshme botojnë tituj bombastikë për rritje pensionesh gjatë vitit. Megjithatë, zakonisht bëhet fjalë për **indeksimin, jo rritjen e pensioneve**. Matematikisht janë e njëjta gjë, ndërsa ekonomikisht edhe ligjërisht nuk janë. **Rritje konsiderohet kur ndodh e pavarur nga rritja e çmimeve**. Indeksimi kompenson pensionistin për rritjen e çmimeve dhe është **detyrim i përcaktuar në ligj**.



Neni 61

(Ndryshuar neni me ligjin nr.9377, datë 21.4.2005, neni 20)

Pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe ato familjare indeksohen çdo vit, për të kompensuar pasojat e ndryshimit të çmimeve të mallrave dhe të shërbimeve të zgjedhura për nivelin minimal të jetesës së pensionistëve. Këshilli i Ministrave cakton listën e mallrave të zgjedhura, mbi të cilën llogaritet indeksi, metodën e llogaritjes dhe datën e indeksimit.





Mit apo Fakt?



"Diabeti ka një kurë! Ai shërohet me recetën time sekrete!"



MASHTRIM



FAKT

Studimet shkencore tregojnë se deri tani, nuk ka një kurë për shërimin e diabetit tip 2, por vetëm mënyra si ta mbash nën kontroll.



*Kujdes!
Mos ia besoni shëndetin tuaj
internetit!
Bëhuni dyshues!*





Shembuj praktikë



✗ PRETENDIMI I RREMË

**DOKTOR ILIR
ALIMEHMETI KËSHILLON
TRAJTIMIN NDAJ
PARAZITËVE**



Një imitim i faqes dhe logos së NewsBomb, një nga portalet më të mëdha në Shqipëri.

Artikulli i rremë paraqitet si intervistë me një mjek të vërtetë (Ilir Alimehmeti) për të mashtruar.

E gjithë përmbajtja është krijuar për të bindur qytetarët të porosisin një produkt të palicensuar.




SI TA KUPTONI MASHTRIMIN?

Adresa e faqes që përhapte lajmin nuk ishte ajo e Newsbomb

Gjithçka që shtyp në faqe të dërgonte tek produkti që po reklamohet – një shenjë klasike e skemave mashtruese.

Lajmi pretendonte se Ilir Alimehmeti ishte patolog, ndërsa ai është mjek epidemiolog klinik.

Vetë doktor Ilir Alimehmeti reagoi publikisht, duke deklaruar se intervista ishte e rreme dhe se emri i tij po përdorej pa leje për të promovuar produkte mashtruese.



Nëse diçka duket shumë e mirë për të qenë e vërtetë, gjasat janë që nuk është e vërtetë!





Shembuj praktikë



✗ PRETENDIMI I RREMË

REUMATOLOGU I QSUT ERVIN RAPUSHI ZBULON SI SHËROHEN DHIMBJET E NYJEVE


MASHTRIM



Një faqe mashtruese ka imituar pamjen e faqes dhe logon e Top Channel.

Artikulli i rremë paraqitet si intervistë me një mjek të vërtetë për të mashtruar.


E gjithë përmbajtja është krijuar për të bindur qytetarët të blejnë një produkt të palicensuar.




SI TA KUPTONI MASHTRIMIN?

Adresa e faqes që përhapte lajmin nuk ishte ajo e Top Channel

ADRESA E VËRTETË E TOP CHANNEL




ADRESA MASHTRUESE



*Kujdes!
Mos ia besoni shëndetin tuaj
internetit!
Bëhuni dyshues!*



Na ndiqni në Faktoje!



Faqja e internetit
www.faktoje.al
Facebook
Faktoje
Instagram
faktoje.al



Kujdes!
Kush të rren,
nuk të do!

Ky projekt është mbështetur
nga Delegacioni i Bashkimit
Europian në Shqipëri



Funded by
the European Union

